



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
ASAMBLEJA

Nr. 4 prot.

Tiranë, më 10.01. 2019

V e n d i m

Nr. / , datë 10 janar 2019

**Për zgjedhjet e reja të kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe ngritjen e komisionit të administrimit të këtyre zgjedhjeve**

**Drejtuar:** Asamblesë së Akademisë së Shkencave;  
Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike në Akademinë e Shkencave;  
Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike në Akademinë e Shkencave;  
Sektorit të bibliotekës dhe të botimeve shkencore; Sektorit të financës; Sektorit të personelit.

**Për dijeni:** KRYEMINISTRISË  
Ministresë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

Mbështetur:

1. Ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*, neni 10, pika 1, 2, 3;
2. Statutit të Akademisë së Shkencave, neni 14,
3. Propozimit të një grupi akademikësh përmes shkresës nr. prot. 452, datë 17.12.2018 drejtuar Këshillit Ekzekutiv të Akademisë së Shkencave (*bashkëmbyllur*); si dhe shkresës nr. prot. 452/1, datë 26.12.2018 të Këshillit Ekzekutiv drejtuar Asamblesë së ASH-së, ku aprovohet kërkesa e tyre për organizimin e mbledhjes së asamblesë më datën 10 janar 2019, ora 11.00 në sallën "Aleks Buda" (*bashkëmbyllur*);

Sa më sipër, Asambleja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, e mbledhur sot më 10 janar 2019, pas arritjes së kuorumit (*shih listën bashkëmbyllur*), miratimit të rendit të ditës dhe të diskutimeve të akademikëve;

### KONSTATOI:

Në bazë të ligjit në fuqi të sipërcituar, duhet të hapet procedura e zgjedhjeve për Kryesinë e re të ASH-së, duke qenë se edhe mandati i të vetmit anëtar të Kryesisë dhe njëherësh të vetmit funksionar me fuqi juridike, Sekretarit Shkencor, përfundon në mbarim të muajit shkurt 2019.

Për sa më sipër Asambleja;

### VENDOSI:

1. Të ngrëjë komisionin e zgjedhjeve të përbërë nga 3 anëtarë të saj për të administruar procesin e zgjedhjeve që përfshin: kalendarin me datat, kriteret dhe procedurat e konkurrimit, pranimin e kandidatëve dhe votimin e fshehtë në asamblenë e ASH-së. Ky komision do të administrojë gjithë procesin, deri në votimin e Kryesisë së re.

Komisioni përbëhet nga:

*Akademik i asociuar* Shaban Sinani

*Akademik* Neki Frashëri

*Akademik* Jani Vangjeli

dhe ka për kryetar akademik Jani Vangjeli caktuar nga vetë komisioni.

2. Asambleja vlerësoi që, meqë projektligji për reformimin e institucionit është në fazën përfundimtare të aprovimit nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Shqipërisë, data e zgjedhjeve të përcaktohet nga komisioni në varësi të hyrjes në fuqi të ligjit të ri.

3. Takimet dhe mbledhjet e Komisionit do të zhvillohen në ambientet e Akademisë së Shkencave. Detyrën e sekretarisë së Komisionit e kryen sekretarja e Kryesisë së Akademisë së Shkencave e cila do të dokumentojë të gjithë veprimtarinë e tij.

4. Komisioni i zgjedhjeve informon rregullisht Asamblenë e ASH-së për të gjitha çështjet që lidhen me mirë organizimin e këtyre zgjedhjeve.

5. Akademia e Shkencave të mbështesë në të gjitha format, veprimtarinë dhe nevojat e funksionimit të komisionit të zgjedhjeve dhe të anëtarëve të tij.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen komisioni i zgjedhjeve, seksionet gjegjëse shkencore të Akademisë së Shkencave dhe nënstrukturat e tjera të saj, përmendur në krye të këtij vendimi.

7. Ngarkohet specialisti i shërbimit IT për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare dhe në rrjetet sociale të Akademisë së Shkencave.

8. Ngarkohet Këshilli Ekzekutiv për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Sekretar Shkencor**

**Vasil S. Tole**

